



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2021:018212

Datë: 08.03.2024

Numri i dokumentit: 05427920

E.nr.538/23

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, me gjyqtarin Faton Ajvazi, me bashkëpunëtorin profesional Besart Selmani duke vendosur në lëndën e përmbarimit të kreditorit V.H. nga Prishtina të cilën e përfaqëson av Fadil Sinanaj nga Gjilani, kundër debitorit Spitali i përgjithshëm - Ferizaj, për pagesën e pagave jubilarë dhe shpenzimet e procedurës, më datë 08.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

PËRFUNDON procedura përmbarimore në lëndën E.nr.538/23, për shkak të përmbushjes së kërkesës së kreditorit.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Ferizaj, me aktvendimin E.nr.538/23, të datës 22.03.2023, e ka caktuar përmbarimin e propozuar nga i autorizuari i kreditorëve kundër debitorit Spitali i përgjithshëm - Ferizaj, për pagesën e borxhit dhe shpenzimeve të procedurës, në bazë të aktgjykimit C.nr.141/21, të datës 16.04.2021.

Meqenëse aktvendimi mbi lejimin e përmbarimit është bërë i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm, gjykata me aktvendimin e datës 15.09.2023, e ka urdhëruar Thesarin e Kosovës pranë Ministrisë së Financave, Punës dhe të Transfereve, që nga llogaria e debitorit ta transferoj shumën e përgjithshme të mjeteve prej 1,479.57euro, në llogarinë e të autorizuarit të kreditorit.

Meqenëse kreditorja e ka realizuar kërkesën e saj, Gjykata konstaton se janë përmbushur kushtet ligjore nga neni 66, par 4, të LPP-së dhe vendosi që ta përfundoj procedurën përmbarimore në këtë çështje juridike përmbarimore.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

E.nr.538/23, më datë 08.03.2024

GJYQTARI

Faton Ajvazi